



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr Prot. Bi Prot. Prot No
2-D/DPK	01-151/16
Nr. Fila Bry. Grainca 02	Data Datum 14-01-2016



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.01.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2499/15, për z. Blerim Grainca, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Blerim Grainca, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në bizneset private Sh.P.K “Univerzal Group”, “Qendra për Trajnime Menaxheriale“, N.Sh “Bi – Consulting”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimit të kësaj shkrese, z. Grainca është takuar me zyrtarët e AKK – së, në këtë rast zyrtari i lartë është bindur me fakte se gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të ushtroj funksion menaxherial në biznes privat.

Zyrtari i lartë z. Grainca ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, për të hequr dorë nga funksioni menaxherial në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Duke parë se procesi i ndryshimeve të kërkuara po zgjatë, Agjencia i ka bërë shkresën e dytë sipas procedurës ligjore që quhet “njoftimi paralajmërues”, me të cilin zyrtarit të lartë i është bërë e qartë se duhet të shmangët situata e konfliktit të interesit brenda afatit të caktuar, përndryshe do të pasojnë masat tjera sanksionuese të parapara me ligj.

Ndërkohë, z. Grainca ka dërguar në Agjenci shkresat zyrtare të lëshuara nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/135/16)(DPKI.03-02/68/16, në të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë ka heq dorë nga funksioni menaxherial në bizneset private të lartëcekura.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

